



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:001144

Datë: 18.02.2021

Numri i dokumentit: 01515611

C.nr. 1/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada-Gllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses K. Prishtinë, kundër të paditurit O.R.H nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për kompensim dëmi material, vlera e kontestit 133.63€, pa shqyrtim të mëtejme me datë 18 shkurt 2021, murr këtë;

A K T G J Y K I M PËR SHKAK TË MOSBINDJES

APROVOHET kërkesë-padia e paditëses Kompania K. Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri O.R.H. nga fshati . . . , komuna e Gjakovës që paditëses të ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 133.63€ (njëqind e tridhjetë e tre euro e gjashtëdhjetë e tre cent) me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë (05 janar 2021) gjer në pagesën definitive dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 20.00 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit nga përmbaruesi privat.

A r s y e t i m

Paditësja ka parashtruar padi pranë kësaj Gjykate me datë 05 janar 2021, kundër të paditurit për kompensimin e dëmit material në shumë 133.63€. Në referat të padisë është shënuar se i padituri deri me datë 06 mars 2017 me qëllim që veti ti sjelli pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njëzorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt me rrjetin elektrik, me këto veprime energjia e shpenzuar nuk është regjistruar. Me atë rast të paditurës i është shkaktuar dëm në shumë prej 133.63€. Shumë e llogaritur në pajtueshmëri me Rregulloren në fuqi "Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të pa autorizuarit të energjisë elektrike" të miratuar nga ZRRE me datë 21 korrik 2009, neni 13 dhe 14.

Sipas Aktgjykimit penale të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr. 954/17, datë 04 qershor 2018, i plotfuqishëm nga data 29 nëntor 2018, i padituri është shpall fajtor, për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Kosovës, përderisa e dëmtuara tani paditësja për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale është udhëzuar në kontest civil.

Sipas nenit 394 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata me aktvendimin C.nr.1/21 të datës 12 janar 2021, ka kërkuar përgjigjen e detyrueshme në padi nga ana e të paditurit.

Nga fletë kthesa në lëndë konstatohet se Aktvendimi për përgjigje në padi i është dorëzuar palës së paditurit me datë 16 janar 2021, i njëjti deri me tani nuk ka dhënë përgjigje në padi.

I padituri brenda afatit të përcaktuar me Ligjin e lartë shënuar nuk i ka paraqitur Gjykatës përgjigje në padi, bazuar në nenin 150.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ky Aktgjykim u murr për shkak të pa dëgjueshmërisë përkatësisht mos bindjes, sepse janë plotësuar këto kushte; a) të paditurit padia dhe Aktvendimi për të dhënë përgjigje në padi i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, b) themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e parashtruara në padi dhe c) faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë pala paditëse.

Pala e paditur detyrohet të paguajë shpenzimet procedurale për taksë gjyqësore palës paditëse në shumë prej 20.00 € sipas nenit 452 të LPK-së.

Bazuar në nenin 160.6 të njëjtit Ligj janë dhënë arsyet që e arsyetojnë dhënien e këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 1/21, Datë 18 shkurt 2021

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada-Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK ; Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.